

GJENDJA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE PERSPEKTIVA E TYRE

ALBANIAN STUDIES AND THEIR FUTURE

Begzad BALIU

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

E-mail: bbaliu@yahoo.com

Çështje të historisë së kërkimit

Një shekull më parë, saktësisht në vitin 1897, Faik Konica tërhoqi vërejtjen për varfërinë letrare të letrave shqipe, duke shtuar se ajo nuk kishte më shumë se pesë a gjashtë libra cilësorë.

Ky konstatim për letërsinë shqipe nuk do të dukej shumë i rëndësishëm për hapjen e konferencës sonë albanologjike, sikur të mos ishte përpjekja e parë për të sjellë sintezën e plotë të pa-surisë historiko-letrare në letrat shqipe dhe sikur ky vlerësim të mos na bëhej sinonim i mendimit tonë kritik për gjendjen shkencore të studimeve albanologjike, sot, një shekull më vonë.

Pas këtij konstatimi të Faik Konicës, përpjekjet për të vlerësuar shkencën dhe kulturën shqiptare nuk kanë munguar, por ka munguar përpjekja për të organizuar atë në nivel të institucioneve shkencore kombëtare dhe të

institucionalizuara. Në vitin 1940, bëhet përpjekja e parë për të themeluar një institucion shkencor, i cili do të merrte përsipër jo edukimin arsimor, misionin e të cilës e kryente Normalja e Elbasanit, po kërkimin shkencor, përkatësisht institucionalizimin e tij në shkallë kombëtare. Po në këtë vit organizohet në Tiranë një Kongres i Studimeve Shqiptare, në të cilin merrnin pjesë, përveç shqiptarëve edhe albanologë të shquar, sado për fat të keq, vetëm të proveniencës italiane. Nga ky kongres lindi "Instituti i Studimeve Shqiptare" me qendër në Tiranë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, janë bërë përpjekje sistematike për formimin e institucioneve arsimore dhe shkencore në fushë të albanologjisë. Në të njëjtën kohë janë organizuar takime shkencore për të caktuar orientimet teorike, metodologjike dhe madje ideologjike të së ardhmes së shkencës shqiptare.

Në vitet 1948-1952, në Tiranë dhe në Prishtinë, janë bërë përpjekje për të parë gjendjen e studimeve (më shumë ideore) brenda institucioneve shkencore në Tiranë dhe në Prishtinë, me theks të veçantë të ardhmen e shqipes standarde.

Në vitin 1962 organizohet Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, në të cilën bardi shkencor dhe ideologjik i kryeprojekteve albanologjike kombëtare Androkli Kostallari, përvijonte kryereferatin e tij sintezën e madhe, drejtimet, fushat dhe kufijtë e studimeve albanologjike, ndërsa veç tjerash, premtonte se do të bëheshin objekt studimi edhe vepra e “atyre shkrimtarëve të njohur të së kaluarës, si Gjergj Fishta, Faik Konica, Zef Skiroi etj”.¹ Pavarësisht nga ky premtim, sikur dihet, veprat e disa krijuesve dhe rezultatet e disa projekteve, jo vetëm nuk do të studiohen por do të bëhen objekt harrese dhe sulmi. Institucionet shkencore në Tiranë, do të bëhen strumbullar i disa prej projekteve të mëdha shkencore, si: Kongresi i Drejtshkrimit, Konferencat e studimeve ilire etj., por nuk do të arrijnë të dalin nga gëzhoja ideologjike e sistemit, dhe më shumë se reflektuese ato u bënë refuzuese të arritjeve të reja.

Në këtë rrjedhë, në Tiranë institucionet shkencore, arsimore dhe kulturore shënojnë një mbyllje të jashtëzakonshme brenda kufijve politik dhe ideologjik, duke përjashtuar madje edhe letërsinë e shkruar në Kosovë

nga *Historia e letërsisë shqipe e gjysmës së dytë të shekullit XX*, ndërsa të njëjtin mision kryejnë edhe studiuesit shqiptarë në Europë dhe Amerikë. Ndonëse vërehen hapa të rëndësishëm bashkëpunimi dhe komunikimi, sidomos në përpjekjen e përbashkët për shqipen standarde, pikërisht në këtë dekadë vërehen hapa tepër të veçantë për projektimin separatist të kulturës shqiptare. Mirëpo, reagimet edhe kësaj here nuk kanë munguar. Në fushë të gjuhës shquhet insistimi i Profesor Idriz Ajetit që në seminarët e albanologjisë të projektoj kontekstin ballkanik dhe ai i Profesor Rexhep Qosjes për projektimin evropian të gjuhës, letërsisë dhe përgjithësisht kulturës shqiptare të albanologjisë. Profesor Rexhep Qosja, që në vitin 1969, veç tjerash kishte shkruar traktatet për studimet albanologjike, institucionet dhe perspektivën evropiane të tyre², që mund të quhen edhe përgjigje koncepteve të Androkli Kostallarit të paraqitura në Konferencën e parë të studimeve albanologjike (1962).

Po në këtë periudhë, në Kosovë bëhen përpjekje individuale dhe kolektive për të dalë nga rrethimi. Në vitin 1968 rihapet Instituti Albanologjik dhe po këtë vit organizohet Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Në vitet '70 themelohet edhe Universiteti i Prishtinës, ndërsa në vitin 1974 fillon punën Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Në fushë të ndërkombëtarizimit të albanologjisë

logjisë seminari paraqet institucionin më të rëndësishëm nacional, përmes të cilit bëhet i mundur popullarizimi i albanologjisë si shkencë dhe historisë e kulturës shqiptare si pjesë e kulturës universale. Po në këtë kohë hapet edhe Akademia e Shkencave në Prishtinë dhe në Tiranë.

Përpjekje për të vlerësuar e rivlerësuar studimet albanologjike dy dekadat e fundit janë bërë kryesisht në fushë të historisë dhe të letërsisë, me qëllim të çlirimit të saj nga konceptet ideologjike³.

Vendet dhe institucionet

Tiranë: Universiteti i Tiranës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra Enciklopedike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Instituti i Folklorit, Instituti i Historisë, Instituti i Arkeologjisë, revista "Filologjia", seria e "AQF".

Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë së Kosovës, Arkivi i Kosovës. Botimet: "Vjetari" "Filologjia", "Kosova", seria e revistave "Gjurmime albanologjike" dhe "Gjuha shqipe".

Shkodër: Universiteti "Luigj Gurakuqi", Buletini i Univeristetit, Seksioni i Albanologjisë, Muzeu i Shkodrës, Seminari ndërkombëtar "Shkodra në Shekuj". Revistat shkencore që botohen në Shkodër: Kolana e botimeve

të trashëgimisë, kryesisht e botimeve para Luftës së Dytë Botërore, të Kishës Katolike. "Buletin shkencor"; "Phoenix", "Hylli i Dritës".

Elbasan: Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Buletini universitetit.

Korçë: Universiteti "Fan Noli".

Gjirokastrë: Universiteti "Eqrem Çabej", dhe Buletini i universitetit.

Vlorë: Universiteti "Ismail Qemali".

Shkup: Universiteti i Shkupit: Katedra za albanski jazik i knizhevnost. Dy drejtime studimesh: pedagogjik dhe perkthyes e interpretues (prapë në dy drejtime: shqiptare dhe jo shqiptare)-nga vitit 2004-2005. Ka statutin e Katedrës nacionale, pra gjuha shqipe është studiuar dhe studiohet si gjuhë amëtare.

Tetovë: Universiteti i Tetovës. Seria e botimeve albanologjike është hapur me veprën e Profesor Rexhep Qosjes. Universiteti i Evropës Juglindore, Seksioni i kërkimeve shkencore. Seria e botimeve vjen si rezultat i konferencave vjetore që organizohen në këtë Seksion.

Podgoricë: Fakulteti i Mësuesisë.

Ulqin: Shoqata "Gjon Buzuku". Revistat: "Lemba" dhe "Dija".

Beograd: Seminari i Albanologjisë, themeluar nga Henrik Bariq.

Romë: Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e Universitetit të Romës (1957); Instituti i Studimeve Shqiptare. "Shejzat" (Le Pleidai).

Palermo: Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë shqipe në Palermo u themelua në vitet 1930-31. Profesor i parë

ishte Gaetano Petrotta. Ekzistojnë tri kolana botimesh: *Albanica* me 27 vëllime; *Studi e testi albanesi* me katër vëllime, ndërkohë që të tjera vëllime të kësaj kolane janë në prërgatitje e sipër; kolana e sapohapur *Balkanistica* me dy vëllime të botuara dhe të tjera në proces botimi. Projekti BESA për mbledhjen dhe dixhitalizimin e leksikut të veprave të autorëve arbëreshë, si edhe projekte të hartuara në kuadër të ligjit të miratuar në vitin 1999 mbi *Mbrojtjen e te drejtave te pakicave gjuhësore në Itali*.

Napoli: Università Orientale di Napoli. Këtu ka katedër të gjuhës shqipe. Jepen dy lëndë: Gjuhë dhe letërsi shqipe; Filologji shqipe; titullar i lëndës është profesor Italo Costante Fortino, që është edhe drejtor i departamentit të Evropës Lindore, ku bëjnë pjesë të gjitha gjuhët e lindjes: shqipja, hungarishtja, rumanishtja, serbishtja, maqedonishtja, greqishtja, rusishtja, bullgarishtja, çekishtja etj. Punimet shkencore behen dhe botohen në kuadrin e departamentit; posaçërisht për shqipen del revista voluminoze "Albanistica".

Kozencë: Lektorati i Gjuhës Shqipe.

Leçe: Katedra e Gjuhës Shqipe.

Paris: Katedra e Gjuhës Shqipe.

Budapest: Kurset e gjuhës shqipe nën drejtimin e albanologut Istvan Schutz.

Universiteti i Arizonës: Lektorati i shqipes.

Mynih: Institut fuer Vergleichende und Indogermanische, Sprachwissenschaft sowie Albanologie, Departement

II für Sprache und Kommunikation, Fakultät fuer Sprach- und Literaturwissenschaften (13/14). Ludwig-Maximilians-Universität Muenchen. Në Mynih botohet edhe vjetari shumë i pasur me studime albanologjike:

Leipzig: Gjuha shqipe mësohet në kuadër të Katedrës së Ballkanistikës.

Vjenë: Shqipja është mësuar e vazhdon të mësohet në Institutin e Indoeuropeistikës të Universitetit të Vjenës. Në Vjenë botohet edhe revista për histori, kulturë, letërsi e politikë "Dardania", të cilën e drejton ish-lektori gjuhsë shqipe në këtë qendër dr. Skënder Gashi.

Poloni: Shqipja egziston si lektorat sot në tre institucione edukuese në Poloni. Në Universitetin e Torunjit "Nikollaj Kopernik", në Universitetin e Varshavës, pranë Shkollës së Gjuhëve Lindore. është mësuar për dy vjet në filialin e Universitetit "Adam Mickiewicz" të Poznanjit, i cili quhet Collegium Europaeum Gnesense, d.m.th.. Kolegji European në Gniezno.

Sofje: Dega e Ballkanologjisë e krijuar në vitin 1994 në Fakultetin e Sllavistikës të Universitetit të Sofjes "Shën Klementi i Ohrit" pranë Katedrës së Gjuhësisë së Përgjithshme nën udhëheqjen e prof. Petja Asenovës. Ekziston edhe veb-faqja elektronike ku botohen studime, recensione dhe tekste letrare kryesisht nga gjuha shqipe në gjuhën bullgare.

Sankt-Peterburg: Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Londër: The School of Slavonic and East European Studies. Gjuha shqipe është njëra prej gjuhëve të studiuara. Instituti i studimeve shqiptare, drejtuar nga studiuesi dhe editorë Destan Bejtullahut.

Selanik: Instituti i gjuhëve Ballkanike. Krahas gjuhës serbe, bullgare, ruse dhe rumune, mësohet edhe shqipja.

Janinë: Lektorati i shqipes.

Follorinë: Lektorati i shqipes.

Athinë: Shoqata shkencore "Lidhja Filologjike Shqiptaro-Greke" dhe revista e saj "Albanogrekica".

Orientimet

Shkenca e albanologjisë i ka tejkalu- ar tashmë disa çështje, që vetëm disa dekada më parë i konsideronte themelore në projektet nacionale të saj.

Në fushë të historisë: albanologjia, problemin e dikurshëm të gjenezës së popullit shqiptar e konsideron të mbyllur dhe të pranuar në institucionet ndërkombëtare pa domosdoshmërinë e mitizimit të saj; çështjen e formimit të kombit shqiptar tashmë e diskuton në kontekst të identitetit të saj evropian; projektimin e historisë së popullit shqiptar e konsideron jo si një histori të Shqipërisë, që në të vërtetë ishte histori e kufijve shtetërorë e politik, po si një histori kombëtare e popullit shqiptar në kufijtë e saj etnografik. Brenda këtyre kriterëve metodologjike pritet të realizohet projekti i ri i historisë së popullit shqiptar, enciklopedisë së popullit shqiptar etj., ndonëse për shkaqe

të caktuara në periudhën tranzitore të kësaj kohe në Tiranë kanë përfunduar të ashtuquajturat projekte kalimtare *Historia e popullit shqiptar* deri në vitin 1912 dhe *Fjalori enciklopedik shqiptar*.

Tema të reja: Rihapja e çështjes shqiptare, studimet për historinë dhe çështjen çame, rikthimi i epokës së Skënderbeut (në 600-vjetorin e lindjes), mbështetja në literaturën ballkanike (përkthimet), kërkimet e Robert Elsie në arkivat dhe bibliotekat e proveniencës Perëndimore, kërkimet e Musa Ahmetit në Arkivat e Vatikanit, kërkimet e Iliaz Rexhes në Arkivat e Turqisë, kërkimet e Dhori Qiriazit në Arkivat e Greqisë, kërkimet e Oliver Shmitit në arkivat italiane dhe austriake, paraqesin kontribute të veçanta në kërkimet e kësaj fushe.

Në fushë të gjuhësisë, albanologjia ka tejkeluar studimin me çdo kusht të problemeve gjuhësore me karakter historik dhe madje me metodologji historiciste, ndërsa gjithnjë e më shumë merret me çështje pragmatike të nevojave të saj: fjalorët elektronikë, fjalorët terminologjikë, diskutimin e standardit gjuhësor në kontekst të rrethanave të reja, problemin e standardizimit të onomastikës etj. Qendrat e studimeve albanologjike në Prishtinë tashmë janë pjesë e projekteve mbarëkombëtare, sikur është Komisioni Ndërkademi- k për Gjuhën Shqipe, në të cilin tash sa kohë po diskutohen jashtë prirjeve ide-

ologjike dhe dogmatike disa çështje të standardit të shqipes, ndërsa pas disa vitesh pune një komision ekspertësh në shkallë Kosove i ka dhënë fund draftit të parë të standardizimit të emërve të Kosovës.

Botimet: Botimi i Atlasit Dialektologjik, përfundimi i botimit të veprave të Çabejt në fushë të etimologjisë; seria e botimeve albanologjike në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera (anglisht e gjermanisht) të cilat nën drejtimin e Profesor Rexhep Ismajlit po botohen në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës; seria e botimeve të trashëgimisë albanologjike drejtuar nga studiuesja Ledi Shamku në Tiranë, fillimi i botimit të veprave të Jup Kastratit, (*Bibliografia albanistike I*), veprat studimore në fushë të fonetikës së shqipes nga Profesor Kolec Topalli; studimet gjuhësore në fushë të shqipes nga Profesor David Luka; botimi i veprave të Kole Ashtës *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, dhe sidomos botimi e ribotimi i shumë fjalorëve dygjuhësorë: anglisht-shqip, italisht-shqip, gjermanisht-shqip, greqisht-shqip e anasjelltas, paraqesin disa nga arritjet më të rëndësishme në fushë të gjuhësisë shqiptare etj. Një fjalor i madh hungarisht-shqip, sikur shprehet autori i tij Prof. Istvan Schvic, katër kilogramësh, pritet të botohet së shpejti.

Në fushë të letërsisë, përveç kthimit të autorëve të ndaluar, në Tiranë është zgjeruar metoda shkencore e

studimit, ndërsa në Prishtinë gjithnjë e më shumë madje edhe nga brezi i ri i studiuesve, po provohet i ashtuquajtur "studim personal" i autorëve dhe veprave letrare. Studimet letrare në Tiranë shkojnë drejt ristrukturimit brenda teorive bashkëkohore të kërkimeve europiane, ndërsa në Prishtinë drejt prirjes për të ndërtuar prirjet e studiuesve të veçantë, sado ato edhe më tej mbeten në nivel të përsiatjeve dhe sikur thuhet të "kërkimit të esencave".

E veçantë: Studimet tekstologjike për letërsinë arbëreshe të Matteo Mandalasë dhe projekti BESA për mbledhjen dhe dixhitalizimin e veprave të autorëve arbëreshë, drejtuar nga profesor Françesko Altimarit; kërkimet e dr. Zymer Nezirit në Fondin e Eposit, të Universitetit të Harvardit, etj. Mbi tridhjetë vëllime me ligjërata e studime të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, paraqesin arritjet më të reja në fushë të studimit, konferencave dhe kërkimeve postkomuniste në fushë të albanologjisë.

Revistat: Kanë përfunduar "misionin" e tyre: *Jeta e re, Nëntori, Jehona, Fjala, Drita* etj., dhe vendin e tyre kanë zënë: *Mehr Licht!, Përprjekja, Poeteka, Sfidë, Ars, FjalA, Aleph*. Është rikthyer edhe *Hylli i Dritës*.

Instituti Alb-Shkenca. Tash së fundi, një grup studiuesish shqiptarë,

të cilët punojnë në disa institucione shkencore në gjithë botën, janë organizuar fillimisht rreth Forumit elektronik Alb-Shkenca dhe Institutit Alb-Shkenca: Prishtinë-Tiranë-Shkup-Diasporë. Një përpjekje metodologjike dhe praktikisht bashkëkohore për të mbështetur dijen shqiptare, e me këtë edhe albanologjinë, si njërin prej dijeve nacionale për të cilën kemi edhe obligime ta njohim dhe ta bëjmë të njohur në përmasa universale.

Perspektiva e kërkimeve albanologjike

Nëse perspektiva e studimeve albanologjike varet prej perspektivës së kërkimeve shkencore në vende dhe arkiva shkencore, si dhe prej metodës së studimit të tyre, atëherë kërkimet albanologjike, përveç në hapësirën e njohur shtetërore dhe shkencore të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, duhet drejtuar edhe në hapësirën etnike, gjuhësore dhe etnografike të banuar nga shqiptarët në Greqi; në arkivat mesjetare dhe antike greke, në hapësirën etnografike dhe gjuhësore e shqiptarëve në Itali, si dhe në arkivat shtetërore, kishtarë, shkencore dhe kulturore të tyre; në arkivat shtetërore dhe kishtarë të zonës bregdetare të Kroacisë; në Arkivat Shtetërore Turke dhe në Arkivat e Vatikanit, ku po bën kërkime kryesisht studiuesi Musa Ahmeti. Pranë Arkivave të Vatikanit dhe Arkivave të Turqisë është me shumë interes që të themelohen edhe Institutet shken-

core nacionale, të cilat do të merreshin vetëm me kërkimet e kësaj natyre.

Në gjuhën, letërsinë, folklorin, historinë dhe etnografinë shqiptare ka shumë interes të bëhen kërkime në disa qendra shkencore të Europës Qendrore: Vjenë, Grac, Mynih dhe sidomos në fondin Gangala të Kopenhagës. Biblioteka Mbretërore e kryeqytetit të Danimarkës, në të cilën gjendet edhe Koleksioni Gangala (sipas lektorit të shqipes Giuseppe Gangala, 1898-1978), mund të përmbysë konceptin për themeluesit gjermanë të albanologjisë shkencore. Arbëreshët mund të bëhen jo vetëm prijës së letërsisë së romantizmit dhe mbledhës të folklorit e përshkrues të etnografisë shqiptare, por edhe themelues të shkencës së albanologjisë në gjysmën e parë të shekullit XIX, brenda të cilës hyn edhe teoria e prejardhjes ilire të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe.

Në kërkim të dorëshkrimeve të panjohura deri më tash apo të identifikuar ndërmjetshëm, përveç veprave të shkruara para Buzukut, në historinë e re, gjetja e dorëshkrimit të *Fjalorit etimologjik* të Norbert Joklit, sigurisht paraqet interes të madh për albanologjinë.

Rikthimi te Faik Konica

Pas reagimit të lexuesve për konstatimin e tij se 'letërsia shqipe nuk kishte veçse pesë a gjashtë vëllime të holla', Konica 'përmirësoi' mendimin e tij, duke u përgjigjur se kur kishte

konstatuar një vëllim kaq të varfër të letrave shqipe nuk kishte menduar për personalitetet, por për veprat. “Kultura kombëtare kishte shumë personalitete të rëndësishme që nga ana kombëtare shqiptare janë me rëndësi, - “por ne, - shtonte Konica, - patëm për qëllim të theksojmë vetëm ato vepra që kanë vlerë më vete”.

Kush do të kundërshtonte sot mendimin e Konicës një shekull më vonë, po të përpiqeshim të bënim një vlerësim të kontributeve tona shkencore të karakterit nacional. Nëse sot konstatojmë se kontributet shkencore nacionale nuk janë veç se një numër më i vogël vëllimesh, se ato që kishte theksuar Faik Konica një shekull më parë dhe se në mesin e atyre veprave të rëndësishme nuk janë as veprat themelore: *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*, e të mos flasim për *Fjalësin kombëtar të shqipes*, (ndërkohë që në kohën e Konicës shqipja kishte në dorëshkrim *Fjalorin e Kristoforidhit* dhe madje *Fjalorin etimologjik të Gustav Majerit*); se në vend të *Enciklopedisë nacionale* kemi *Fjalorin e vogël enciklopedik*; se në vend të *Historisë së popullit shqiptar* kemi gjysmën e parë të saj; se në vend të *Historisë së letërsisë shqipe* kemi disa pjesë të saj; se ende nuk kemi një vepër akademike për *Letërsinë popullore*, etnografinë, muzikologjinë, arkeologjinë, se edhe *Gramatikën e shqipes standarde* nuk arritëm ta botojmë të plotë; se edhe ai numër i vogël leksikonësh të botuar deri më tash janë rezultat i punës individuale të disa ‘ilumi-

nistëve’, po jo edhe punës shkencor të institucioneve shkencore, të cilat janë themeluar pikërisht për këto synime, si do të reagonin sot individët dhe institucionet shkencore.

Duke e ditur që më parë se edhe ndaj këtyre konstatimeve reagime do të ketë edhe një shekull pas reagimeve që iu bënë Faik Konicës, dëshiroj të përgjigjem që më parë: në kohën tonë, kemi jo vetëm individualitete të shquara shkencore, kulturore, filozofike, letrare etj., por kemi edhe institucione shkencore kombëtare: akademike, universitare, shkencore, institute të specializuara etj., të cilat, kudo me emrin e tyre i nderojnë popujt e qytetëruar të botës, por edhe këtu fjalën e kishim për ato vepra themelore të cilat i mungojnë shkencës së albanologjisë, dmth shkencës nacionale.

Bibliografia

1. Androkli Kostallari, *Gjendja e Studimeve Albanologjike në Shqipëri, probleme dhe detyra të reja*, KPSA, USHT-IHGJ, Tiranë 1965, f.15-59.
2. Shih, 1969: Rexhep Qosja, *Studimet albanologjike dhe institucionet e tyre*; 1977: Mbledhja e lëndës dhe sintezat e tyre (organizimi, studimet albanologjike sot, studimet albanologjike nesër, prej studimeve individuale te studimet ekipore); 1981: *Studimet albanologjike në perspektivën evropiane*, (gjashtë kushte të perspektivës evropiane të studimeve albanologjike).
3. Shih, Sesionin shkencor “Letërsia si e tillë”.